



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 24/08**

**Prishtinë, më 06.10.2008, ora 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Kosara Nikolić, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj dhe Behxhet Pacolli.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Kapllan Kastrati, Emine Fazliu, Naim Ibrahimaj nga ZAGJ, Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Kosovës, Teki Shala nga NDI, Sylë Ahmeti gazetar “Kosova Sot”, Shqipe Osmani gazetare nga “Bota Sot”, Bajram Limani gazetar nga “KOSOVA PRESS”, monitorues nga Z.P.R.K ,OSCE, NDI, KDI,

**Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhjet e 11 dhe 24 shtator 2008**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Auditorit Gjeneral mbi pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2007 nr.21.0.1.-2007-08**
- 4. Të ndryshme**

**Kryesuesi,** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për rendin e ditës.

**Armend Zemaj**, duke komentuar pikën e tretë të rendit të ditës, theksoi se do të ishte mirë që të shqyrtonim edhe raportet e auditimit të organizatave tjera buxhetore.

**Safete Hadërgjonaj**, duke u ndërlidhur me pikën e tretë e rendit të ditës, theksoi se nuk është hera parë që ky komision shqyrton raportin e auditimit për Kuvendin. Në vazhdim të diskutimit bëri vërejtje përfaqësuesve të Zyrës së Auditorit Gjeneral, për mosdërgim me kohë të raportit deputetëve, të cilët detyrohen t'i sigurojnë ato nga interneti. Prandaj kërkoi që në të ardhmen këto raporte të dërgohen me kohë në Kuvend ashtu siq parasheh edhe ligji.

**Kryesuesi**, u pajtua me propozimin për komisioni t'i shqyrtojë raportet e auditimit edhe për organizatat tjera, por për shkak të angazhimeve të komisionit, nuk ka mundësi këtë vit. Premtoi se në të ardhmen do të bëhen përpjekje në këtë drejtim. Por sipas kryetarit e obligueshme është të shqyrtohet raporti i auditimit për Kuvendin sepse jemi organ i tij. Gjithashtu u pajtua me vërejtjet dhe kërkoi që në të ardhmen materialet e raporteve të auditimit të dërgohen me kohë formën zyrtare në Kuvend

**Kapllan Kastrati**, arsyetoi vonesën e dërgimit të raportit, për shkak të praktikës së re ZAGJ-së si organ tashmë i pavarur. Premtoi se në të ardhmen raportet për organizatat buxhetore do të dorëzohen me kohë në Kuvend.

Me vërejtje e bëra, rendit ditës miratohet pa ndryshime.

## 2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhjet e 11 dhe 24 shtator 2008

**Safete Hadërgjonaj**, bëri vërejtje në procesverbalin e dt. 24.09.2008, theksoi se në diskutimin e saj për pikën e tretë të rendit të ditës është keqkuptuar, prandaj kërkoi që të bëhen përmisimet të cilat i paraqiti.

**Haki Shatri**, po ashtu duke komentuar procesverbalin e dt. 24.09.2008, bëri vërejtje se ai nuk figuron në listën e pjesëmarrësve në mbledhje, e që në fakt ai ka qenë por ka lëshuar mbledhjen me arsye ligjore, për shkak se nuk i ka marrë materialet për shqyrtim kohë. Prandaj kërkoi që emri i tij të shënohet në procesverbalin në fjalë.

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 11 shtator 2008 u miratua pa vërejtje, ndërsa procesverbali dt. 24 shtator 2008, u miratua me vërejtjet e znj. Hadërgjonaj dhe z. Shatri, dhe kërkoi që ato të inkorporohen në procesverbal.

## 3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Auditorit Gjeneral mbi pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2007 nr. 21.0.1.-2007-08

**Besa Gaxherri**, bëri më vërejtje për marrjen me vonesë të materialeve nga Kuvendi që pikën e tretë, dhe si rezultat i kësaj nuk ka mundur të i lexojë dhe analizojë.

**Kryesuesi**, duke i përgjigjur znj. Gaxherri, theksoi se për të njëjtat arsye, ky material nuk do të jetë objekt diskutimi. Më pas hapi diskutimin.

**Hajdin Abazi**, duke komentuar raportin, theksoi se shtatë rekomandimet që rrjedhin nga raporti janë duhet të ndihmojnë ecjen përpara të efikasitetit të mbajtjes së evidencave, zbatimin e ligjit si dhe shtimin

e mundësisë së kontrollit të rrjedhave biznesore në kuadër të Kuvendit, në mënyrë që të ketë një transparencë më të madhe. Kërkoi nga Sekretari i Kuvendit të tregoj se sa rekomandimet e ZAGJ-së kanë arritur të realizohen dhe në çfarë niveli, si dhe sa ka mundësi që brenda vitit të eliminohen të shkeljet dhe të mos manifestohen dukuritë e njëjta. Sipas z. Abazi të gjitha institucionet e në veçanti Kuvendi duhet të jetë shembull i zbatimi të ligjeve dhe rregullave.

**Kryesuesi**, theksoi se auditimi është bërë në bazë të disa mostrave dhe në bazë të tyre kanë rrjedhur rekomandimet. Nga rekomandimet e pasqyruara në raport shifet se janë tri fusha më të djeshme dhe si pika më të dobëta të paimplementuara: problemet me lëndët e prokurimit (të njëjtat defekte, të njëjtat shkelje të procedurave që i kemi pasur në vitin 2006), mosregjistrimi i pasurisë (aseteve) dhe mosmbyllja e avanceve. Në vazhdim kërkoi të përqendrohen në problemet e indentifikuara në raport, në atë se sa kanë qenë të zbatueshme dhe sa janë të zbatueshme standartet e kontabilitetit në sektorin publik, sa ka qenë efikas sistemi i auditimit brenda Kuvendit, cila është mangësia e procedurave të kontrollit.

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi se i ka bërë përshtypje realizimi e 19 rekomandimeve gjatë vitit 2007 nga 22 të dhëna në vitin 2006. Një tjetër përshtypje e veçantë ka të bëjë me konstatimin e auditorit në mungesën e informatave të mjaftueshme për të dhënë një vlerësim real për gjendjen në Kuvend. Duke shfrytëzuar praninë e Sekretarit kërkoi sqarimi për problemin që ka pasur auditori në marrjen e informatave. Një tjetër çështje tjetër sipas znj. Hadërgjonaj që ka vërejtur në këtë raport është çështja e funksionimit të auditorit të brendshëm. Kuvendi edhe pas shtatë vitesh nuk ka pasur auditim të brendshëm. Kjo ka vështirësuar punën e auditorit, për shkak të pamundësisë që të shoh raportet e këtij auditori. Sa i përket mungesës së sistemit të kontabiliteti sipas standarteve, një situatë e tillë është në të gjitha institucionet e vendit. Prandaj në këtë drejtim theksoi se duhet të krijohet një sistem i kontabilitetit të unifikuar në bazë të standarteve të kontabilitetit. Vërejtje bëri edhe për problemet e paraqitura në kategorinë mallrat dhe shërbimet, pastaj mosmbyllja e avanceve. Një e metë tjetër ka të bëjë në mosmarrjen e masave të duhura për regjistrimin e pasurisë. Por mbi të gjitha, problemet me të mëdha identifikojnë çështjet e prokurimit dhe parregullsitë janë bërë aty (siq është rasti i nënshkrimit të kontratave për lëndët e prokurimit nga sekretari në kundërshtim me ligjin). Për të gjitha këto parregullsi dhe të gjetura kërkoi që personat përgjegjës të japin llogari dhe në tjetër të ndërmerren masa për evitimin e tyre.

**Myrvete Pantina**, vlerësoi raportin të punuar mirë për nga ana teknike, por në përmbajtje shifet se ka disa të gjetura, disa parregullsi, prandaj kërkoi që në të ardhmen të mos përsëritet praktika e mosrespektimit të rekomandimeve. Përkundrazi Kuvendi duhet të jetë shembull për zbatimin e ligjeve. Zjn. Pantina theksoi se si rezultat i mosinformacioneve të mjaftueshme për auditorin nuk mund të konkludojm se të dhënat në raport janë të plota. Pyeti sekretarin përse nuk janë ofruar këto informatat shtesë. Përse nuk ekziston sistemi i kontabilitetit. Sistem i dobët i kontrollit të brendshëm, auditori brendshëm është emëruar me vonesë, dhe si rezultat i kësaj kanë mbetur pa audituar menaxhimi buxhetit, procedurat e prokurimit, procedurat e pagesave dhe dosjet e personelit. Nuk është themeluar komisioni i auditimit. Znj. Pantina po ashtu bëri vërejtje për problemet e shfaqura në fushën e prokurimit, për mos inventarizimi e pasurisë.

**Haki Shatri**, theksoi se raporti tregon se puna e Kuvendit lidhur me çështjet financiare është e preferueshme. Sipas tij dallohen dy lloj shkeljesh: shkeljet e renda materiale dhe procedurale. Shkeljet procedurale gjinden në të gjitha institucionet. Në këtë raport vërehen shkelje të natyrave procedurale, e që me rekomandime mund të eliminohen pa e dëmtuar buxhetin e Kuvendit. Edhe shkeljet e prokurimit, arsyetimet tregojnë se nuk janë bërë shkelje të procedurave por veprimet janë bërë për arsye praktike. Realizimi i 19 nga 22 rekomandimet është përparësi. Ka filluar regjistrimi i pasurisë. Besoj se shifrat nga shkeljet materiale janë të vogla, siq është rasti i avanceve, prandaj shprehu besimin se Kuvendi do të eliminojë këto shkelje. Z. Shatri theksoi se mund të kërkojmë me rekomandim të respektohen afatet për eliminimin e të gjetura në raport si shkelje.

**Kryesuesi**, duke u ndërlidhur me parafolësin theksoi se me anë të shkeljeve procedurale vie te shkeljet materiale. Të tills shkelje konsiderohen edhe shumat më të vogla.

**Besa Gaxherri**, theksoi se pasi po shqyrtojmë raportin të bazuar në disa mostra, nuk mund të konsiderohet se është bërë një revizion. U pajtua me vërejtje që mos qasja në informata të mjaftueshme nga auditori, ka ndikuar në konstatimin e gjendjes reale në Kuvend. Një problem që është evidentuar ka të bëjë me mosregjistrimin e asetëve, Kuvendi nuk ka njohuri për pasurinë kapitale dhe jokapitale. Pastaj vonesat në funksionimin e auditimit të brendshëm. Pagesat e bëra në para të gatshme, që kane tejkaluar limitin individual, dhe nuk i'u janë përmbajtur rregulloreve të Thesarit për vendosjen e limitit e parasë së gatshme. Një çështje tjetër ka të bëjë me mosmbylljen e avanceve. Të gjeturat në prokurim, kërkojnë të bëhet një revizion gjeneral. Nxjerrja e vendimeve pa u mbështetur në baza ligjore krijon mundësinë për keqpërdorime, kjo ka ndodhur në Kuvend. Kuvendi nuk disponon mbi vendndodhjen e pajisjes së teknologjisë informative të blerë që nga 2002. Problemet e shfaqura në realizimin e shpenzimeve kapitale (mosrestaurimi i restorantit, mosrenovimi i kulmit), pastaj transferimi i mjeteve prej një kategori ekonomike në të tjetrën. Materiale na jep shume rekomandime tjera, andaj lind nevoja të bëhet një revizion gjeneral apo ngritje e një komisioni hetimor.

**Armend Zemaj**, vlerësoi përgatitjen e raportit. Sa i përket të gjeturave të pasqyruara në raport, kam krahasuar edhe raportin e vitit 2006 të Kuvendit dhe vërejtur se ka përmisime të dukshme. Duke komentuar propozimin e znj. Gaxherri për ngritjen e një komisioni hetimor, theksoi se kjo nuk ka nevojë për arsye se egzistojne institucionet kompetente dhe raste e gjetura mund të hetohen nga ato. Lidhur me problemet e shfaqura në prokurim, duhet të vie përgjegjësia në bazë të shkeljeve që mund të kenë bërë personat përgjegjës. Arsyja e mosmbylljes së avanceve është si rezultat i mosserizozitetit të deputetëve. Të gjeturat mund të figurojnë në por nuk tregojnë se janë bërë keqpërdorimi të mëdha dhe me vlerë. Z. Zemaj kërkoi shpjegime nga sekretari se a ka ndërmarrë masa Kuvendi për evitimi e tyre dhe për llogarinë ndaj atyre që i kanë janë përgjegjës për ato. Personat e tillë duhet të japin llogari edhe për shumat më të vogla.

**Kosara Nikolić**, vlerësoi përgatitjen e mirë të raportit në aspektin teknik nga auditorit gjeneral. Theksoi se duhet shqyrtohen rrethanat pse ka ardhur tek mospërmbushja e obligimeve nga organizatat buxhetore. Komisioni duhet të diskutoj për shkaqet që kanë sjellur rekomandimet e jo të ndalemi në çështjet që janë përfshirë në raport. Ndërsa pas rekomandimeve të bëra, mbetet përgjegjësia e Kuvendit që të implementoj ato dhe të gjeturat të mos përsëriten më.

**Shkumbin Demaliaj**, duke pasur parasysh faktin se jemi grup parlamentar i ri, nuk mund të flasim si kanë rrjedhur procedurat e raportit të vitit 2007. Por nga ajo qfarë është shkruar, shifet se raporti është hartuar me ngutësi dhe shënimet e pasqyruara më shumë i'u kushtohen ngjarjeve të vitit 2008 se sa vitit paraprak. Z. Demalija theksoi se nëse raporti kalon në për t'u diskutuar në seancë, ne si grup parlamentar do të shprehim opinionet tona atje.

**Kryesuesi**, kërkoi të mos kalojnë raportet me lehtësi sepse po përsëriten të njëjta probleme me vite. Së paku në kuptimin moral të ketë përgjegjësi për moszbatim të ligjit dhe rregullave. Kam pasur presione të mos shqyrtohet fare ky raport. Përkujtoi për shkeljet në prokurim, rastin e nënshkrimit të sekretarit të kontratës së tenderit (shkrimi është publikuar edhe në gazetë) që është në kundërshtim me ligjin e prokurimit. Personat përgjegjës duhet dhënë përgjegjësi. Shkelje të njëjtat konsiderohen si keqmenaxhimi po ashtu edhe keqpërdorimi.

**Kapllan Kastrati**, raporti i vitit 2007, tregon se ka përparime në implementimin e rekomandimeve të auditorit për dallim me raportet e viteve të kaluara. Emërimi i vonshëm i auditorit të brendshëm ka paraqitur pengesë në auditimin me kohë në veçanti në fushat siq është prokurimi. Rekomandimet tona

janë bazuar në mostrat e gjetura nga puna jonë e shtuar në mungesë të auditorit. Mosvlerësimin e tërë pasurisë ka bërë të pamundur për të dhënë një opinion sa pasqyrat financiare të Kuvendit paraqesin gjendjen reale. Nuk kemi pasur dokumente për të ditur vlerën e pasurisë. Është dashur të krijohet komisioni për të bërë këtë vlerësim të pasurisë. Pasqyrat financiare duhet përgatitur dhe mbajtur në mënyrë të pavarur (problem në të gjitha organizatat buxhetore). Duhet rritet sistemi i kontrollit të brendshëm. Është e pamundur të bëhet auditimi total por përmes mostrave. Auditimi bazohet në marrjen e mostrave që kanë vlerë më të madhe sepse rreziku i tyre është më i lartë.

**Kryesuesi**, pyeti se nga gjysma e mostrave janë konstatuar shkeljet e paraqitura, sa do të jenë shkeljet nga gjysma tjetër e mostrave në lëmine e prokurimit më të vogla apo më të mëdha.

**Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit të Kosovës**, duke komentuar vërejtjet dhe sugjerimet e parafolësve, theksoi se shqyrtimi i raportit nga Komisioni për Buxhet dhe Financa e forcon dhe e rrit obligimin në menaxhimin e mjeteve buxhetore dhe financiare të Kuvendit të Kosovës. Raporti është prezantuar në Kryesi e cila e ka miratuar dhe në afatin e paraparë do të hartojë planin e realizimit të rekomandimeve të ZAGJ-së. Teksti i raportit përmban disa formulime që në përmbajtje nuk janë të drejta. Duke i'u përgjigjur pyetjeve dhe rekomandimeve për mosofrimin e informatave theksoi se nuk është për shkak të asaj që zyrtarët kompetent të administratës nuk ofruar informacione. Prandaj konstatimi i tillë i paraqitur në raport nuk qëndron.

Sa i përket regjistrimit të pasurisë, ajo është bërë por jo krejtësisht në vlerën monetare, në disa raste inventarizimi i objektit është bërë në bazë të fakteve ekzistuese. Ku nuk ka pasur të tilla fakte, komisioni ka përcaktuar një vlerë të përafërt në bazë të çmimit të tregut. Nuk është bërë regjistrimi i ndërtesës për shkak të çmimit të lartë të ofruar nga kompanitë e sigurimit. Sa i përket projektit të qendrës protokolare duke ditur natyrën e rrjedhës së tij, arsyeja e mosregjistrimit ka ndodhur, për shkak se nuk kemi ditur se a të trajtojmë si pasuri të veçantë. Lidhur me çështjen e softuerit e vitit 2001 nuk ka pasur fletëpranim as fletdorëtim, është një punë në të cilën nuk ka fakte se qfarë është bërë më të. Ndërsa rekomandimi i veturës zyrtare ka të bëjë me një veturë të dhuruar nga Ministria e Shërbimeve Publike në vitin 2002-2003 dhe atë momentalisht e shfrytëzon një anëtar i Kryesisë. Në vërejtjet për krijimin e sistemit të kontabilitetit, mos posedimi i softuerit nuk do të thotë se nuk është gjendja e sigurt. Bëhen barazimet tre mujore për të gjitha transaksionet me Thesarin. Lidhur me organizimin e auditimit të brendshëm, Auditorja është pranuar në punë me 1 gusht 2007 dhe që nga ajo kohë ka hartuar dy raporte. Duke përgjigjur vërejtjeve për pagesat në para të gatshme, theksoi se në Kuvendin e Kosovës disa herë shtrohen kërkesa që duan të zgjidhen për një kohë të shkurtër. Si rezultat i mospengimit të disa aktiviteteve ka rezultuar me gjashtë raste pagesash në kesh në shumë prej 564 euro. Duke u përgjigjur pyetjeve lidhur me prokurimin, theksoi se konstatimet e bëra nuk e kanë rënduar procesin e rrjedhës së tenderimit. Njoftimi i fituesve është bërë përmes shtypit, ndërsa për humbësit përmes telefonit. Vlerësimin e punëve e ka bërë komisioni duke besuar në paanshëmriin e tyre. Sa i përket ndarjes së tenderëve ka të bëjë më një rast të vetëm. Arsyeja ka qenë për shkak se e njëjta firmë nuk ka mundur të pasi Kuvendin me tonerë që i shfrytëzon disa lloje. Është bërë largimi i disa zyrtarëve të prokurimit për shkeljet që kanë bërë. Si rezultat i mungesës së këtyre zyrtarëve (zyrtarit certifikues) është penguar procesi në realizimin e shpenzimeve kapitale. Është konstatuar se më mirë të zvarriten procesi se sa të shkilet ligji. Problemi i avanceve ka të bëjë ekskluzivisht me deputetët. Sa i përket vërejtjeve për pagave dhe mëditjeve, theksoi se buxhetin e Kuvendit e menaxhon Kryesia me ato. Lidhur me dështimin e restaurimit të resturantit, pengesat janë shfaqur për shkak se tri tenderë dështojnë në mungesë së tre ofertuesve që parasheh ligji. Të gjitha shkeljet e konstatuara në raport janë të natyrës objektive se sa subjektive. Sa i përket rekomandimeve të konstatuara, nga materiale që keni marrë shifet se janë të implementuara, zbatimit i efektit do të shihet në ditët në vijim.

**Armend Zemaj**, pyeti Sekretarin lidhur me atë se zyrtari i prokurimit a është larguar vet apo është suspenduar. Ndërsa për makinën kërkoi sqarim si shfrytëzohet ajo kur dihet se nuk ka fletëregjistrim.

**Safete Hadërgjonaj**, përkrahu mendimin për një revizion gjeneral të Kuvendit. Pyeti sekretarin qfarë është bërë më mjetet e ndara për blerjen e veturës prej 230 mijë euro. Bëri vërejtje për anashkalimin e Komisionit, në rastin e shqyrtimit të raportit nga Kryesia.

**Kryesuesi**, theksoi se posedon kopjet e dy kontratave të lëndëve të prokurimit (për të cilat është shkruar edhe në gazetë) Kanë të bëjnë me renovimin e kulmit dhe bifënë lartë. Kontratat nuk janë realizuar por janë kryer veprimet që janë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Kërkoj sqarime nga sekretari.

**Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit të Kosovës**, duke i përgjigjur z. Zemaj, theksoi se tenderi për kulm në vitin 2007 është udhëhequr nga zyrtari i prokurimit Hilmi Bajrami, i cili i ka bërë lajthitje në udhëheqjen e procedurës dhe për këto arsye është larguar nga puna. Procedura është ndaluar. Lidhur me mjetet e veturës, kontesti gjyqësor ka përfunduar ndaj palës keqpërdoruese në favor të Kuvendit, ekzekutimi i saj do të bëhet në momentin kur pala humbëse të sigurojë mjetet të cilat nuk i ka për momentin. Gjykata ka për obligim të kujdeset për ekzekutimin e këtij aktgjykimi.

**Naim Ibrahimaj**, theksoi se Kuvendi ka qenë transparent në ofrimin e të gjitha dokumentacionit që është kërkuar. Duke komentuar vendimin e Kryesisë për shtesa, theksoi se nuk ka bazë ligjore ( për ato vendos MEF në konsultim me Qeverinë dhe MSHP). Regjistrimi i pasurisë nuk vlerësohet kur i mungon vlera monetare, Kuvendi nuk e ka bërë shpалosjen e pasurisë në tërësi (rasti ndërtesës).

**Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit të Kosovës**, në përgjigjen për shtesa, në vitin 2006, ato janë lejuar me nënshkrimin e MEF-it dhe kryetari i Kuvendit. Në vitin 2007, lejimi i tyre është bërë me udhëzim administrativ të nënshkruar nga PSSP-ja.

**Kryesuesi**, konstatimi se nuk janë ofruar informacionet shtesë është jo i qëndrueshëm. Auditori ka të drejtë të hulumtojë tërë materialin, nga zyrtarët gjegjësis të kërkoj sqarime shtesë me apo pa pëlqimin e tyre. Prandaj theksoi se do të kërkoj nga Kryesia një revizion të jashtëm për ZAGJ-së.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shtatë vota PRO një KUNDËR (zgj. Besa Gaxherri) dhe një abstenim (zgj. Kosara Nikolić në mungesë të materialit në gjuhën serbe) nxori këtë:

#### REKOMANDIM

1. Sekretari i Përhershëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës sa më parë të përgatit planin e veprimit për implementimin e të gjitha rekomandimeve të auditorit.
2. Të caktohen afate konkrete mbi implementimin e këtyre rekomandimeve.
3. Të funksionalizohet sa më parë Njësia për Auditim të Brendshëm dhe të formohet Komisioni i Auditimit në bazë të Ligjin nr. 02/L-74 për Auditimin e Brendshëm, neni 5.
4. Zyra e Auditorit Gjeneral duhet ta riformuloj paragrafin në përmbledhjen e përgjithshme ku thuhet se *“Auditorët nuk kanë qenë në gjendje të marrin dëshmi të mjaftueshme në shumë raste dhe se nuk kanë qenë në gjendje të shprehin opinionin për deklaratat financiare dhe se është e mundur që këto informata kanë ekzistuar por nuk u janë paraqitur auditorëve”*. Ky konstatim i auditorëve len të kuptohet se zyrtarët e Kuvendit nuk kanë ofruar bashkëpunim të duhur me auditorët.

5. Kërkohet nga Sekretari i Kuvendit të Republikës së Kosovës që në afate sa më të shkurtra t'i mbyll avancat e tërhequra dhe t'i respektojë rregulloret në fuqi mbi shpenzimin e parasë së gatshme.

## 5. Të ndryshme

**Kryesuesi**, njoftoi anëtarët me ekspertin e punësuar nga NDI z. Teki Shala i cili do ta ndihmoj komisionin në punët dhe detyrat që i ka në vazhdim.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

**Përgatitur nga**  
**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

---

**Gani KOCI**